



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS

Nr. ____ . Prot
____ / ____ /2019

Datë

Shtojca 13

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Për Shoqërinë: “SHPRESA- AL”, sh.p.k me NIPT K31321021N me adresë: Tiranë, Njësia Bashkiake Nr.9, Rruga “Urani Pano”, mbrapa “Veve Center”, Pallati Nr. 11, Kati 2.

Procedura e Prokurimit: “Kërkesë për Propozim” punë.

Numri i Referencës se procedurës/lotit : REF-97119-12-06-2018

Përshkrim i shkurtër i Kontratës: “Sistemim asfaltim i rruges kryesore Fshati Konaj, NJ.A Bushat” me fond limit: 12.000.000,00 (dymbëdhjetë milion) lekë pa t.v.sh me afat kohor për ekzekutimin: 10 ditë kalendarike

Burimi i Financimit: “Të ardhurat e veta + Transfertë “

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 17.12.2018 ora 10:00

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Çmimi më i ulët

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 49 datë 11.12.2018

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në këtë procedurë tre pjesëmarrës me vlerat përkatëse të ofruara:

1. **Operatori ekonomik:** “SHPRESA- AL”, sh.p.k me NIPT K31321021N me adresë: Tiranë, Njësia Bashkiake Nr.9, Rruga “Urani Pano”, mbrapa “Veve Center”, Pallati Nr. 11, Kati 2. Ku ka paraqitur ofertën me vlerë: **11.974.876** (njëmbëdhjetë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh ose **14.369.851** (katërmëdhjetë milion e treqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e një) lekë me tvsh.
2. **Operatori ekonomik :** “ KEVIN-CONSTRUKSION”sh.p.k, me NIPT K71401004W, me adrese: Tirane, Rruga Adem Jashari, Ndertesa 4, Hyrja 10, Njesia Bashkiake Nr.5, nuk ka paraqitë ofertë!
3. **Operatori ekonomik :** JV Karl Gega Konstruksion me nipt J66703076W me adresë në: Shkoder Lagjia Perash, Rruga Bardhyl Dani, Pallati nr.3, kati dytë majtas, zona kadastrale nr. 8594, nr. Pasurie 2/683+1+1+ & Alba Via sh.p.k, me nipt J81527001Q

me adresë në: Tiranë Rruga Sulejman Delvina, Pallati Fati, shk.1, ap.19 . Ku kanë paraqitur ofertën me vlerë: **10.816.391** (dhjetë milion e tetëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e treqind e nëntëdhjetë e një) lekë pa tvsh, ose **12.979.669** (dymbëdhjetë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë me tvsh.

❖ ***Eshtë Skualifikuar operatori ekonomik :***

1. “ **KEVIN-CONSTRUKSION**”, **sh.p.k.**, me NIPT K71401004W, me adrese: Tirane, Rruga Adem Jashari, Ndertesa 4, Hyrja 10, Njesia Bashkiake Nr.5

Arsyet e skualifikimit:

Nuk ka paraqitur dokumentet e mëposhtme të kërkuara sipas Dokumenteve Standarte të Tenderit: Si dhe nuk keni paraqitur ofertë për këtë objekt prokurimi!

KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- b) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- c) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 4.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar, sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;

- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Deklaraten mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;

b. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë: Sipas Shtojcës 11.

2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

a) Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të Bilancit të tre viteve të fundit ushtrimore (2015, 2016, 2017), të çertifikuara nga organet tatimore, si dhe raportin e ekspertit kontabel për rastet kur subjekti është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”. *(Ne rast se ofertuesi është bashkim i operatoreve, çdo anetar i këtij bashkimi duhet të paraqesë këto dokument)*

b) Vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron mesatare vjetore për vitet 2015, 2016, 2017 e cila duhet të ketë një vlerë sa 50 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet. *(Ne rast se ofertuesi është bashkim i operatoreve, çdo anetar i këtij bashkimi duhet të paraqesë këto dokument duke e plotësuar proporcionalisht me % e marre përsiper në marrëveshjen e bashkëpunimit)*

c) Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për tre vitet e fundit (2014, 2015, 2016), pranë njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin sipas regjistrimit në QKB. *(Ne rastet e bashkimit të operatoreve çdo anetare i grupit duhet të dorëzojë vërtetimet e kerkuara)*

d) Një vetëdeklarim nga operatori ekonomik që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor /nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent.

2.3 Për kapacitetin teknik:

a)Furnizime të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit të aktivitetit të operatorit, në vlerën prej jo më pak se 50% e fondit limit të vënë në dispozicion.

ose

punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera gjatë tre viteve të fundit të aktivitetit të operatorit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme

Si dëshmi për përvojën e mëparëshme kërkohën:

- Kontrata të ngjashme të lëshuara nga enti publik që ka realizuar këtë lloj furnizimi, e shoqëruar me vërtëtimin e realizimit me sukses nga Autoriteti Kontraktor.

OSE

Ne rastin e pervojës së mëparshme të realizuar në sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm faktura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

b) Liçensa profesionale të shoqërisë lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

- NP-1 A Punime germimi në tokë
- NP-4 A Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale
- NP-7 A Ujësjiellësa, gazësjellësa, vajsjiellësa, vepra kullimi e vaditje
- NP-11 A Njërtim për N/Stacionet, kabinat e transfermatorëve, linja e TN të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë
- NP-12 A Punime të inxhinierisë së mjedisit
- NS-1 A Punime për prishjen e ndërtimeve
- NS-6 A Sinjalistikë rrugore jo ndriçuese
- NS-18 A Punime topogjeodezike .

c) Shoqëria duhet të paraqesë:

1. Çertifikate të cilësive së punimeve për ndërtim civil **ISO 9001-2015**, në rastet e bashkimit të operatoreve cdo anëtarë i grupit duhet të dorëzojë çertifikatën e kërkuar (e vlefshme).
2. Çertifikate të menaxhimit të mjedisit **ISO 14001-2015**, në rastet e bashkimit të operatoreve cdo anëtarë i grupit duhet të dorëzojë çertifikatën e kërkuar (e vlefshme).
3. Çertifikate mbi kushtet e sigurisë dhe shëndetit të punonjësve **OHSAS 18001-2007**, në rastet e bashkimit të operatoreve cdo anëtarë i grupit duhet të dorëzojë çertifikatën e kërkuar (e vlefshme).
4. Çertifikate **PASS 99:2012**, në rastet e bashkimit të operatoreve cdo anëtarë i grupit duhet të dorëzojë çertifikatën e kërkuar (e vlefshme).

ç) Numri mesatar i punonjësve të operatorit ekonomik ofertues, për tre vitet e fundit (2015, 2016, 2017) të jetë jo më i vogël **140 punonjës**, i vertetuar nga organet tatimore.

d) Operatori duhet të ketë në listapagesë stafin teknik të mëposhtem:

- Inxhinier ndërtimi minimumi 1 (nje)
- Inxhinier gjeodet/topograf minimumi 1 (nje)
- Inxhinier Mjedisit minimumi 1 (nje)
- Inxhinier elektrik minimumi 1 (nje)
- Mjek i firmes minimumi 1 (nje)

(Për të cilët duhet të paraqes Kontrate Pune dhe Diplome)

e) Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i Shoqërisë) **Drejtesin** Teknik të punimeve në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtem:

- i. Diplome
- ii. Kontrate pune të vlefshme deri në përfundimin e kontratës

f) Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund të vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojitet për ekzekutimin e kontratës.

g) **Disponimi i mjeteve të mëposhtme:**

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
<i>Mjet transporti vetshkarkues (kamion) mbi 5 ton</i>	<i>2 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Motosaldatriçe</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Autobot uji</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Eskavator me goma</i>	<i>1 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Gjenerator 100kë</i>	<i>2 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Betonjere</i>	<i>4 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Pompa uji</i>	<i>2 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Vibrator për pllaka trotuari</i>	<i>2 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Vibrator betoni</i>	<i>2 cope</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>

a) Operatori Ekonomik të paraqesë deklaratën sipas shtojcës Nr. 10.

b) Për mjetet që shenohen në regjistratë publike duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit Teknik, siguracionin e mjetit, leje transporti lëshuar nga Bashkia, fotografi dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikatën e kontrollit Teknik, siguracionin e mjetit dhe fotografi duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qerës/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

c) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike.

d) Makineritë e mesiperme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera, (Deklaratë nga Administratori i Shoqërisë Ofertuese).

Për këto arsye ju skualifikoheni nga kjo procedurë prokurimi!

❖ **Eshtë Skualifikuar operatori ekonomik :**

2. “J.V Karl Gega Konstruksion & Alba Via sh.p.k,” Arsyet e skualifikimit:

Ju keni paraqitur një Deklaratë me datë 22.12.2018, protokollur me nr. 8247 prot me datë 24.12.2018, ku Hartjan Sallaku administrator i shoqërisë “Karl Gega Konstruksion” deklaroi se: “Për arsye të mospasjes mundësi për të ndjekur objektin në rast të shpalljes së fituesit deklaroi se heqin dorë nga ky tender”!

Për këtë arsye ju skualifikoheni nga kjo procedurë prokurimi!

4. Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin “**SHPRESA-AL**”, sh.p.k me NIPT K31321021N me adresë: Tiranë, Njësia Bashkiake Nr.9, Rruga

“Urani Pano”, mbrapa “Veve Center”, Pallati Nr. 11, Kati 2. Ku ka paraqitur ofertën me vlerë: : **11.974.876,00** (njëmbëdhjetë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh ose **14.369.851** (katërmëdhjetë milion e treqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e një) lekë me tvsh, **është identifikuar si oferta e suksesshme**. Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Vau Dejes, qyteti Vau Dejes sigurimin e Kontrates, siç parashikohet ne dokumentat e tenderit, brenda (30 diteve) nga dita e marrjes se këtij njoftimi.

Ne rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, tenderi do te anulohet si pasojë e mospasjes së një subjekti tjetër të suksesshëm, ne bazë të ligjit nr 9643, date 20.11.2007 ” Per Prokurimin Publik, i ndryshuar”, neni 24, pika ç..

Njoftimi i klasifikimit është bërë në datë **24.12.2018**.

Ankesa :Ska

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

KRYETARI

ZEF HILA

